



Datë: 22.07.2025
Numër Protokolli: 5746/2025

A.nr.1160/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë ankimore të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1160/2025 të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.B, kundër Vendimit me numër protokolli 212-3/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1160/2025, e datës 18.06.2025, e parashtruar nga ankuesi F.B.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi F.B (tutje referuar vetëm: *ankuesi*), më datë 18.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 212-3/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 10.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje referuar MFPT), ndërsa, kjo e fundit, më datë 17.07.2025, ka dhënë përgjigje në ankesë duke përcjell provat materiale ndërlidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën, sepse:

Sipas provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar si pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe së i njëjti sipas Urdhrit për Gradim me numër Reference: 1/1101/2025, të datës 12.05.2025, të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ushtron pozitën Nënkolonel, me detyrë Oficer Ekzekutiv/Këshilltar për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Tutje, sipas provave të lëndës rezulton së Ministria e Mbrojtjes, më datë 24.01.2025, ka parashtruar kërkesë pranë Komisionit për Kushte të Tregut të Punës-MFPT, lidhur me njohjen e së drejtës së ankuesit në shtesë për kushte të tregut të punës, për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkëfinancuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kërkesë e mbështetur në nenin 7 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës. Ndërsa, Komisioni për Kushte të Tregut të Punës më Vendimin me numër protokolli 212-3/2025, të datës 19.05.2025, ka refuzuar kërkesën e datës 24.01.2025, të Ministrisë së Mbrojtjes, mbi arsyetimin se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara me nenin 7, paragrafi 2.1 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër protokolli 212-3/2025, të datës 19.05.2025, të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, më pretendimin së më aktin e kundërshtuar i është mohuar e drejta për përfitimin e shtesës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkëfinancuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën dhe të përshihet në shtesë për kushtet e tregut të punës.

Në kuptim të kompetencës së Këshillit për vendosje lidhur më këtë çështja juridike-administrative, Kolegji ju referuar nenit 3, paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (me tej vetëm LZP), më të cilin është përcaktuar se: “... 2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim: 2.1. gjyqtaret/ët dhe prokuroret/ët; 2.2. **personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse**;...”, dhe si rrjedhojë, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor del fakti i pakontestueshëm se personeli komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të ligjit për zyrtarët publikë, rrjedhimisht, të njëjtit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil sipas nenit 6 paragrafi 1, nënpika 1.1 dhe paragrafi 2 të LZP, kështu që, duke qenë së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, juridiksion ky i përcaktuar me nenin 102 të Kushtetues së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton së KPSHCK-ja nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore sipas nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, ku shprehimisht parashihet se: **Neni 78, paragrafi 1**” 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. **Neni 79 paragrafi 1:** Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit dhe meqenëse të Rregulloreje (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, nuk përbën rregullim ligjor mbi të drejtën e ankesës kundër vendimeve të Komisionit për Kushte të Tregut, atëherë, pala ankuese udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1160/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.B;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Komisionit për Kushte të Tregut të Punës, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK- së.